

Mbi vaksinimin mbrojtës kundër sëmundjeve të pneumokokut te foshnjat / fëmijët e vegjël – me vaksinë të konjuguar

Infeksionet nga pneumokoku shkaktohen nga bakteret *Streptococcus pneumoniae*. Ekzistojnë mbi 90 serotipa, por jo të gjithë janë të rrezikshëm për njeriun. Patogjeni transmetohet përmes pikave të vogla të infektuara. Rreth 10 për qind e të rriturve dhe një përqindje më e lartë e fëmijëve kanë baktere të pneumokokut në zonën e hundëve dhe grykëve. Ato janë baktere të shëndetshme që nuk shkaktojnë sëmundje. Një çrregullim i imunitetit lokal apo të përgjithshëm të trupit mund të çojë në një shtim të patogjenëve dhe në sëmundje nga pneumokoku, kryesisht në sëmundje si infektion në mushkëri apo meningjit, septicemi, pezmatime të veshit të mesëm apo sinusit. Veçanërisht te fëmijët në vitet e para të jetës dhe te personat e moshuar, por edhe te njerëzit e të gjitha grupmoshave me sistem imunitar të dobësuar apo me sëmundje kronike, këto baktere mund të shkaktojnë infeksione që paraqesin rrezik për jetën e tyre ose, si pasojë e meningjitit, mund të shkaktojnë dëmtim të përhershëm të sistemit nervor qendror ose humbje të dëgjimit.

Vaksina

Të dyja vaksinat kundër pneumokokut për të cilat flitet këtu njihen si vakcina të konjuguara. Përmes prodhimit në një mënyrë të veçantë këto vakcina janë shumë efikase dhe mjaft të tolerueshme edhe te fëmijët e vegjël. Ato përmbajnë pjesë të membranës bakteriale të patogjenit (Polysaccharide) dhe veprojnë kundër tipave më të shpeshtë të patogjenëve që shkaktojnë sëmundje nga pneumokoku. Vaksinat e konjuguara kundër pneumokokut veprojnë kundër sëmundjeve të rënda invazive nga pneumokoku (septicemia, meningjiti dhe pneumonia) si dhe kundër pezmatimit të veshit të mesëm. Në Gjermani gjenden dy lloj vaksinash të ndryshme të konjuguara: Prevenar 13[®], e cila vepron kundër 13 serotipave dhe lejohet për fëmijët mbi 6 javësh, adoleshentët dhe të rriturit. Synflorix[®], e cila vepron kundër 10 serotipave dhe mund të përdoret te fëmijët nga 6 javë deri në 5 vjeç. Vaksinat injektohen me gjilpërë në muskul (injeksion intramuskular). Distanca kohore e vaksinimit është e njëjtë për të dyja vaksinat. Në varësi të moshës, për një vaksinim të plotë nevojiten 1 deri në 3 injeksione: sa më i vogël të jetë fëmija aq më shumë vaksinime nevojiten për të marrë një rezultat sa më mbrojtës nga vakcina, i cili është i rëndësishëm mbi të gjitha te foshnjat. Të lindurit e parakohshëm bëjnë gjithsej 4 vakcina. Mjeku juaj mund t'ju shpjegojë më mirë të gjithë procedurën e saktë.

Vaksinimi kundër pneumokokut te fëmijët e vegjël mund të bëhet njëkohësisht me vakcina të tjera të rekomanduara, por në vende të ndryshme (p.sh. kofsha e djathtë dhe e majtë, krahu i djathtë dhe i majtë); toleranca dhe efikasiteti nuk ndikohen negativisht nga vaksinimi në të njëjtën kohë me vakcina të tjera. Mbi fillimin dhe kohëzgjatjen e mbrojtjes nga vaksinimi mund t'ju informojë mjeku juaj.

Kush duhet të vaksinohet?

Vaksinimi kundër pneumokokut rekomandohet për të gjithë fëmijët në vitin e 1-rë dhe të 2-të të jetës së tyre, madje sa më parë të jetë e mundur.

Përveç tyre, të gjithë personat mbi 60 vjeç duhet të vaksinohen. Një vaksinim kundër pneumokokut rekomandohet gjithashtu edhe për fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit shëndeti i të cilëve është më i rrezikuar si pasojë e ndonjë sëmundjeje të fshehtë.

Për vaksinimin kundër pneumokokut të fëmijëve mbi 2 vjeç, adoleshentëve dhe të rriturve, përveç vaksinave të konjuguara, disponohet gjithashtu edhe një vaksinë e ashtuquajtur Polysaccharid. Për zgjedhjen e vaksinës së duhur këshillohuni me mjekun e vaksinimit.

Kush nuk duhet të vaksinohet?

Gjatë një sëmundjeje akute me temperaturë që ka nevojë për mjekim, vaksinimi duhet të shtyhet deri në rikuperimin nga kjo sëmundjeje. Por: infeksionet e lehta nuk janë arsye për të mos u vaksinuar. Nëse pas një vaksinimi të mëparshëm me të njëjtën vaksinë ju janë shfaqur reaksione të forta ose nëse është konstatuar hipersensitivitet ndaj ndonjërit prej përbërësve të vaksinës, mjeku juaj do t'ju këshillojë mbi nevojën dhe mundësinë e vaksinimeve të mëtejshme.

Nëse pacientët kanë tendencë hemorragjike dhe si pasojë nuk duhet të bëjnë injeksione në muskul, kjo vaksinë duhet të bëhet duke krahasuar avantazhet dhe rrezikun dhe, sipas rastit, duhet të përdoret një teknikë tjetër injeksioni.

Sjellja pas vaksinimit

I vaksinuari nuk ka nevojë për pushim të veçantë; megjithatë për 3 ditë pas vaksinimit ai duhet të shmangë sforcimet fizike. Personat që prirën të kenë reaksione kardiovaskulare apo tek të cilët janë konstatuar alergji të tipit të menjëhershëm, para vaksinimit duhet ta njoftojnë mjekun në lidhje me këtë.

Reaksione të mundshme lokale dhe të përgjithshme pas vaksinimit

Pas vaksinimit, përveç synimit të rritjes së imunitetit dhe në këtë mënyrë mbrojtjes nga sëmundja, në rreth 1 në 10 të vaksinuar mund shfaqen skuqje ose ënjtje me dhimbje. Ky reagim është tregues i përballjes normale të trupit me vaksinën dhe ndodh kryesisht brenda 2 deri 3 ditëve dhe rrallë zgjat më shumë. Shpesh këto reaksione janë të lidhura me një forcim të ndjeshëm të vendit të vaksinimit dhe me një ndjeshmëri ndaj presionit të ushtruar mbi të, gjë që pengon lëvizjen.

Gjithashtu brenda 1 deri në 3 ditëve, rrallë edhe më gjatë, mund të shfaqen edhe simptoma të përgjithshme si temperaturë nga 39°C dhe më e lartë, kuarje, plogështi, gjumë jo i qetë ose shqetësime të stomakut dhe zorrëve (p.sh. mungesë oreksi, të vjella, diarre), rash, dhimbje kyçesh dhe muskujsh, dhe gjithashtu dhimbjet e kokës janë të shpeshta. Pas administrimit të dozës vijuese të fëmijët e vegjël, pra pas dozës së 3-të ose të 4-të të vaksinimit, si dhe pas vaksinimit të të rriturve shpesh është vërejtur një ndjeshmëri kur ushtrohet presion te gjymtyrët, gjë që tregohet me kufizim të lëvizjeve.

Zakonisht këto reaksione janë të përkohshme dhe largohen shpejt dhe pa pasoja.

A janë të mundshme komplikacionet nga vaksinimi?

Komplikacionet nga vaksinimi janë pasoja shumë të rralla të shkaktuara nga vaksinimi, të cilat shkojnë përtej një reaksioni normal dhe që e rëndojnë dukshëm gjendjen shëndetësore të personit që do të vaksinohet. Në raste të veçanta të foshnjat ose të fëmijët e vegjël, si pasojë e rritjes së temperaturës, arrihet deri në konvulsion febril, i cili zakonisht zhduket pa pasoja. Vetëm në raste individuale të foshnjat dhe fëmijët e vegjël janë vërejtur gjendje shoku të shkurtra, të cilat shfaqet me mosreagim dhe me muskulaturë të plogësht, por rikuperimi nga to është i shpejtë dhe pa pasoja. Pas vaksinimit me vaksinën e konjuguar të pneumokokut mund të shfaqet rrallë një reaksion alergjik i lëkurës (p.sh. urtikarie, kuarje) ose i rrugëve të frymëmarrjes, i cili në raste të veçanta mund të arrijë

deri në shok. Te foshnjat dhe fëmijët e vegjël mund të shfaqen më shpesh komplikacione individuale si p.sh. reaksione febrile ose konvulsione kalimtare gjatë kryerjes së vaksinës së konjuguar të pneumokokut në të njëjtën kohë me vaksinat 6-valente. Mjeku juaj mund t'ju këshillojë në lidhje me këtë.

Këshillimi për efektet anësore të mundshme me mjekun e vaksinimit

Përveç kësaj fletëpalosjeje, mjeku juaj ju ofron një bisedë informuese.

Nëse pas një vaksinimi shfaqen simptoma që i tejkalojnë reaksionet e përkohshme lokale dhe të përgjithshme të sipërpërmendura, mjeku i vaksinimit është gjithmonë në dispozicionin tuaj.

Ju mund të kontaktoni me mjekun e vaksinimit:

Deklaratë për mosmbajtje përgjegjësie

Përkthimi i origjinalit të fletës informuese (publikuar më: 8/2015) është kryer me lejen e Deutsches Grünes Kreuz e.V. (Kryqi i Gjelbër Gjerman) me kërkesë të Institutit-Robert Koch. Teksti në gjuhën gjermane ka përparësi. Nuk mund të mbahet asnjë përgjegjësi për gabime të mundshme në përkthim, e aq më pak për aktualitetin e përkthimit në fjalë në raste të rishikimeve të mëvonshme të materialit në gjuhën gjermane.

Emri _____

Name

Vaksinimi mbrojtës kundër sëmundjeve të pneumokokut – me vaksinë të konjuguar*Schutzimpfung gegen Pneumokokken-Erkrankungen – mit Konjugatimpfstoff*

Bashkëlidhur gjeni një fletëpalosje mbi kryerjen e vaksinimit mbrojtës kundër sëmundjeve të pneumokokut me vaksinë të konjuguar. Aty përfshihen të dhënat kryesore mbi sëmundjet që shmangen nëpërmjet vaksinimit, mbi vaksinën, vaksinimin, si dhe reaksionet dhe komplikacionet e mundshme të vaksinimit.

Anliegend erhalten Sie ein Merkblatt über die Durchführung der Schutzimpfung gegen Pneumokokken-Erkrankungen mit Konjugatimpfstoff. Darin sind die wesentlichen Angaben über die durch die Impfung vermeidbaren Krankheiten, den Impfstoff, die Impfung sowie über Impfreaktionen und mögliche Impfkomplicationen enthalten.

Para kryerjes së vaksinimit kërkohen të dhënat shtesë si më poshtë:

Vor der Durchführung der Impfung wird zusätzlich um folgende Angaben gebeten:

1. A gëzon shëndet të plotë personi që do të vaksinohet në momentin e vaksinimit?

Ist der Impfling gegenwärtig gesund?

Po (Ja)

Jo (Nein)

2. A vuan nga ndonjë alergji personi që do të vaksinohet?

Ist bei dem Impfling eine Allergie bekannt?

Po (Ja)

Jo (Nein)

nëse po, nga cila _____

wenn ja, welche

3 A janë shfaqur te personi që do të vaksinohet shenja alergjike, temperaturë e lartë apo ndonjë reaksion i pazakontë pas një vaksinimi të mëparshëm?

Traten bei dem Impfling nach einer früheren Impfung allergische Erscheinungen, hohes Fieber oder andere ungewöhnliche Reaktionen auf?

Po (Ja)

Jo (Nein)

Nëse dëshironi të dini më shumë rreth vaksinimit mbrojtës kundër sëmundjeve të pneumokokut – me vaksinë të konjuguar, pyesni mjekun e vaksinimit!

Falls Sie noch mehr über die Schutzimpfung gegen Pneumokokken – mit Konjugatimpfstoff – wissen wollen, fragen Sie den Impfarzt!

Në takimin për vaksinimin ju lutem merrni me vete kartelën e vaksinimit!

Zum Impftermin bringen Sie bitte das Impfbuch mit!

Deklaratë miratimi*Einverständniserklärung***për kryerjen e vaksinimit mbrojtës kundër sëmundjeve të pneumokokut – me vaksinë të konjuguar***zur Durchführung der Schutzimpfung gegen Pneumokokken-Erkrankungen – mit Konjugatimpfstoff*

Emri i personit që do të vaksinohet _____

Name des Impflings

Lindur më _____

geb. am

Unë u njoha me përmbajtjen e fletëpalosjes dhe në një bisedë me mjekun/mjekën time u informova në mënyrë të detajuar mbi vaksinimin.

Ich habe den Inhalt des Merkblatts zur Kenntnis genommen und bin von meinem Arzt/meiner Ärztin im Gespräch ausführlich über die Impfung aufgeklärt worden.

 Unë nuk kam pyetje të tjera.*Ich habe keine weiteren Fragen.* Unë e pranoj vaksinimin e propozuar kundër sëmundjeve të pneumokokut me vaksinë të konjuguar.*Ich willige in die vorgeschlagene Impfung gegen Pneumokokken-Erkrankungen – mit Konjugatimpfstoff – ein.* Unë e refuzoj vaksinimin. Jam vënë në dijeni për anët negative të mundshme të refuzimit të vaksinimit.*Ich lehne die Impfung ab. Über mögliche Nachteile der Ablehnung dieser Impfung wurde ich informiert.*

Shënime Vermerke _____

Vendi, data Ort, Datum _____

Nënshkrimi i personit që do të vaksinohet
ose i kujdestarit të tij.

Unterschrift des Impflings bzw. des Sorgeberechtigten

Nënshkrimi i mjekut/mjekes

Unterschrift des Arztes/der Ärztin